



11-11-2014 11:49

## Kërkohet formulë e re për financimin e Universiteteve Publike

**Ka filluar tryeza e rrumbullakët me temë: “Autonomia dhe llogaridhënia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë”.**

Drejtoresha e Departamentit të Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Drita Kadriu, ka thënë se kjo tryezë ka për qëllim shkëmbimin e përvojave nga universitete të ndryshme të botës.

“Ky takim do të zgjasë 3 ditë dhe ka për qëllim që të bëjë shkëmbimin e përvojave të financimit të arsimit të lartë nga grantmbajtësit e projektit, Universitetit të Austrisë dhe partnerët tjerë që vinë nga Gjermania dhe Spanja dhe përvojat e universiteteve tona publike kryesisht mbështeten në përvojën e Universitetit të Prishtinës në mënyrë që projekti i cili do të zgjas 3 vjet në dizajnimin e autonomisë financiare të arsimit të lartë të nxjerr rezultatet konkrete dhe të kemi një koncept të ri të financimit në arsimin e lartë”, ka thënë ajo.

Kurse, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Sophie Beaumont, ka thënë se ky

projekt është i rëndësishëm për arsimin e lartë, pasi një gjë e tillë, sipas saj, do të sjellë dobi për gjenerimin e të ardhurave në këto institucione arsimore.


“Ky projekt është tejet i rëndësishëm për arsimin e lartë në Kosovë dhe ne kemi të pritura shumë të mëdha sa i përket kësaj dhe rezultateve që do të jap dhe natyrisht çështja e autonomisë financiare dhe llogaridhënies ka qenë çështje e diskutuar që është shtruar për një kohë të gjatë në Kosovë dhe mendoj se Kosova, institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, institucionet publike do të mund të përfitojnë mjaft shumë nga praktikat më të mbara që ekzistojnë në shtetet e Bashkimit Evropian dhe sigurisht autonomia në këto fusha mund të sjellë dobi për lidhje për gjenerimin e të ardhurave të cilat janë shumë të rëndësishme në hulumtimet që kanë mungesë të fondeve dhe për të operuar në universitete duhet pasur kapacitete të fuqishme hulumtuese për të përmirësuar cilësinë e arsimit të lartë për studentë dhe për të rritur cilësinë e universiteteve”, ka deklaruar ajo.

Kurse, drejtori i Departamentit të Financave në MASHT, Fehmi Zylfiu, ka thënë se aplikimi i kësaj formule të financimit do t’i ndihmoj edhe UP-së në ndarjen e buxhetit për institucionet publike të arsimit të lartë.

“Qëllimi i formulës së re është krijimi më efikas i planifikimit të buxhetit në pikëpamje më reale, përshtatshmëria e fondeve të cilat janë të mjaftueshme rreth ndarjes së buxhetit dhe rreth zhvillimeve të aktiviteteve në arsimin e lartë, transparenca e cila duhet të jetë në ndarjen e fondeve për arsimin e lartë e cila deri më tash ka qenë një ndarje me parametra të cilat i kemi pas të aprovuara në bazë të të cilave është bërë planifikimi i buxhetit për arsimin e lartë e formula është instrument i financimit të drejtë për të gjitha universitetet ku tjetër kriter i cili bazohet në përshtatshmërinë dhe vendimmarrjen për arsimin. Kjo formulë parasheh dhe shërben për një planifikim më të mirë dhe më përgjegjës për vitet fiskale”, ka thënë ai.

Tryeza e rrumbullaket do të zgjas 3 ditë dhe gjatë kësaj kohe pritet që të prezantohen formula dhe modele të ndryshme të vetëfinancimit të Universiteteve Publike.

Safari Power Saver  
Click to Start Flash Plug-in



**Partneriteti për Qeverisje  
të Hapur në Kosovë  
fton qytetarët të kontribuojnë  
me idetë e tyre**

